



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 25 Shkurt 2021

Nr. 103

**VENDIM**

Objekt: Për shqyrtimin e denoncimit për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj z. Bujar Çela.

Kërkues : Lëvizja Socialiste për Integrim

Ndaj: Z. Bujar Çela, deputet i Partisë Socialiste

Baza ligjore: Neni 19, paragrafi 1, shkronja “dh”, “f”, “n”, paragrafi 2, dhe 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 60, 61, dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9, datë 24.12.2020 i Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

**VËREJ:**

I.

Vlerësimi paraprak

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është raportuar një denoncim në ndërfaqen e “Aktiviteteve të Ndaluar”, në rubrikën “Kallëzo”, nga subjekti politik Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI), për shkelje të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Sipas denoncimit më datë 2.2.2021 me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 1238 ora 09:03, pretendohet se: “Më datë 26.12.2020 deputeti i Partisë Socialiste, Qarku Fier, Bujar Cela, në Facebook-un e tij ka publikuar disa foto me qytetarë duke u dorëzuar lejen e legalizimit të shtëpisë së tyre në Golem, me mbishkrimin “Puna vazhdon. Në këtë fund viti 12 familjeve të Njësisë Administrative Golem

Për shqyrtimin e denoncimit për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj z. Bujar Çela.

Data: 25 Shkurt 2021

Nr. 103



*u dorëzova lejet e legalizimit të banesave që i kane ndërtuar me aq mund. Mbetet akoma punë për të bërë. Duke ju uruar Gëzuar Vitin e Ri 2021 dhe me besimin se ky vit i ri 2021 të jetë fundi i procesit të legalizimeve. Punë#Vizion#Durim.”*

Sipas denoncuesit: *“Ky veprim i tij bie në kundërshtim me vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator. Më konkretisht neni 3, pika 1.3, germa “a” e këtij vendimi.”*

## II.

### Analiza ligjore

Sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht kërkesat lidhur me kompetencën e organit publik për shqyrtimin e tij.

Neni 3, paragrafi 2 i vendimit nr. 9/2020, *“Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”*, të Komisionit Rregullator ka përcaktuar rrethin e subjekteve të cilët ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi sipas përcaktimit të mëposhtëm:

*“Kryeministri, administrata e tij, Zëvendëskryeministri, ministri dhe zëvendësministri, administrata e tyre, kryetari i bashkisë zëvendësit dhe administrata e tij, Prefekti dhe administrata e tij, drejtori i përgjithshëm i agjencive apo institucioneve në varësi të Kryeministrit, Këshillit të Ministrave ose Ministrit, drejtori i përgjithshëm, drejtorët e departamenteve, drejtorët e drejtorive dhe administratat respektive, drejtuesit dhe anëtarët e organeve kolegjiale, enteve, bordeve, çdo drejtues i shoqërive tregtare në administrim nga shteti si edhe në çdo ent ku shteti zotëron aksione e kapitale/kuota apo emëron shumicën e organit mbikëqyrës ose të organit administrues, titullari dhe zëvendësit e tij për ndërmarrjet shtetërore, gjatë periudhës kohore 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, e kanë të ndaluar të drejtojnë, të marrin pjesë apo të kontribuojnë në çfarëdolloj forme, në veprimtari publike të ndaluara sipas këtij vendimi”.*

Duke qenë se denoncimi i subjekti politik (LSI) i datës 2.2.2021, lidhet vetëm me deputetin z. Bujar Çela, theksoj se deputeti nuk përfshihet në rrethin e subjekteve të përcaktuara në paragrafin 2 të nenit 3 të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.

KAS ka shqyrtuar rrethana dhe fakte të ngjashme ndaj të njëjtave subjekteve me vendimin nr nr. 4 të datës 22.01.2021 të Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, i cili ka arsyetuar se:



...Shpërndarja e lejeve të legalizimit është veprimtari rutinë e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, e cila nuk ndërpritet për shkak të periudhës zgjedhore. Ajo që vendimi ndalon është kryerja e saj përgjatë veprimtarive publike. Veprimtari publike, në kuptimin e pikës 1 të nenit 92 të Kodit Zgjedhor dhe të germës “b” të nenit 2 të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator është vetëm veprimtaria që është e hapur për pjesëmarrjen e publikut dhe të medias, si dhe ajo që ka në agjendë informimin e publikut rreth saj.

Nuk rezulton e provuar që kryerja e veprimtarisë të jetë bërë në vende të hapura për publikun, në sheshe ose në njësitë e shërbimeve komunitare të zonës, apo që publiku të jetë ftuar në çfarëdo lloj forme për të marrë pjesë në veprimtari, apo media të ketë shoqëruar deputetin apo të ketë raportuar për ndonjërin nga këto veprimtari.

Postimi në llogarinë e deputetit në Facebook nuk e bën veprimtarinë publike. Sikurse pranohet nga vetë denoncuesi, qëllimi i veprimtarisë ka qenë shpërndarja e certifikatave, jo informimi i publikut rreth tyre. Postimi në Facebook nga ana e deputetit i përket një kohe të mëvonshme (në këtë kuptim formon veprimtari tjetër, të ndryshme nga e para) dhe është bërë për qëllime promovimi.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve bazuar vendimin nr. 4 të datës 22.01.2021 të Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, ka informuar Agjencinë Shtetërore të Kadastrës dhe ka kërkuar që, në respektim të standardit të zgjedhjeve dhe neutralitetit të administratës publike, deputetët, deri në datën e zgjedhjeve të mos ftohen në veprimtaritë rutinë të administratës qendrore dhe vendore të tij, të cilat zhvillohen nëpërmjet kontaktit, komunikimit dhe bashkëpunimit me zgjedhësit.

Agjencia Shtetërore e Kadastrës me shkresën nr. 3309, datë 18.02.2021, protokolluar me tonën me shkresën nr. 1343, datë 19.02.2021, për dijeni Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka njoftuar të gjitha drejtoritë vendore të ASHK-ve për njohjen dhe zbatimin e vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator, dhe marrjen e masave në rast mos përmbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë vendimin.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, paragrafi 1, shkronja “dh”, “f”, “n”, paragrafi 2, dhe nenet 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:



## V E N D O S:

1. Mosfillimin e procedurës administrative për shkak se kallëzimi nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
3. Kunder këtij vendimi mund të bëhet ankim në KAS brenda 3 ditëve nga marrja dijeni.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**  
**Ilirjan CELIBASHI**



Data: 25 Shkurt 2021  
Nr. 103

Për shqyrtimin e denoncimit për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj z. Bujar Çela.